



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400032/2

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë dhënien e plotë të dokumentacionit të kërkuar nga shtetasi S.G, në bazë të kërkesës që ai ka paraqitur më datë 26.09.2013.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

FIER

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.G, banues në Fier, lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentave zyrtare të kërkuara nga ana e tij.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë dhe dokumentacionit bashkangjitur, rezulton se shtetasi S.G ka kërkuar pranë institucionit që Ju drejtoni dosjen e shpërblimit nr.54 që familja e tij përfiton nga i ndjeri, gjyshi i tij, Y.L, të cilit i është njohur "Statusi i Dëshmorit të Atdheut". Kërkesa e tij është regjistruar me nr.2193 prot. datë 26.09.2013, konfirmuar kjo edhe nga një shkresë e institucionit tuaj, kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur. Që nga koha e depozitimit të kërkesës, është interesuar vazhdimisht për çështjen e tij, por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

E drejta e informimit është e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku në pikën 2 të tij, thuhet shprehimisht se:

"Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore".

Duhet theksuar se e drejta e informimit është një nga të drejtat e afirmuara në akte të rëndësishme ndërkombëtare siç edhe, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 19), apo Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (neni 10).

Në nenin 3 të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, përcaktohet se:

“Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion për dokumentet zyrtare, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe personave që ushtrojnë funksione shtetërore, pa qënë i detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”.

Neni 4, i ligjit të sipërcituar jep kuptimin dhe përcaktimin se kur mund të kufizohet dhënia e dokumentave zyrtare dhe me konkretisht;

“Nëse informacioni i kërkuar për një dokument zyrtar kufizohet me ligj, autoriteti publik i lëshon kërkuarit një deklaratë me shkrim, në të cilën tregohen arsyet e mosdhënies së informacionit dhe rregullat në bazë të të cilave ai mund ta kërkojë atë.

Nëse kufizimi është vetëm për një pjesë të të dhënave të dokumentit zyrtar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit”.

Referuar rastit konkret, konstatojmë se:

-Në përputhje me nenin 7, të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999, të sipërcituar, ku thuhet shprehimisht se: *“Kërkuarit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkohet të informohet”*, ankuesi ka paraqitur në përputhje me ligjin, kërkesë zyrtare për marrje informacioni dhe kopje dokumentacioni zyrtar.

-Kërkesës zyrtare, për informacionin dhe kopjen e dokumentacionit të kërkuar prej ankuesit, nga ana e institucionit tuaj, nuk i është kthyer përgjigje me shkrim, brenda afatit të përcaktuar në nenin 10, të Ligjit nr. 8503 datë 30.06.1999, në të cilin thuhet shprehimisht se:

“Autoriteti publik vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të kërkesës brenda 15 ditëve nga depozitimi i saj. Në rast të mospranimit të kërkesës, përgjigja negative, e plotë apo e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik”.

Pra, sa më lart, arrihet në konkluzionin se kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës për t’u informuar me të gjithë dokumentat përkatës zyrtare, të kërkuar nga ana e ankuesit.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*, të paragrafit 2, të nenit 3, si dhe të paragrafit të parë, të nenit 18, të Ligjit nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, në të cilët thuhet se: *“Autoriteti publik është i detyruar të japë çdo informacion në lidhje me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe”*, *“Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji...”*,

REKOMANDOJMË

Dhënien e plotë të dokumentacionit të kërkuar nga shtetasi S.G, në bazë të kërkesës që ai ka paraqitur më datë 26.09.2013.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI